



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORI

Nr. 691 Prot.

Tiranë, më 01/07/2020

URDHËR

Nr. 56, datë 01.07.2020

PËR

**SHPALLJEN E FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE
PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhrit nr. 175, datë 30.06.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", si dhe Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës" neni 5, pika 3,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Data e fillimit të procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, është data 01.07.2020.
3. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, është data 30.07.2020.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al